

Konferenca

Gjëndja e Artit Bashkëkohor në Shqipëri: Zhvillimet e Ardhshme

e Premte 29 Janar 2010 ora 18.00,

Tek salla e Ministrise të Turizmit, Kultures, Rinisë dhe Sporteve

Pjesa e parë

- Eskpozita Onufri: Historia dhe momentet kyçe: roli i kuratorit
- Vleresimi i artit bashkëkohor në Shqipëri
- Artisti dhe shoqëria

Pjesëmarës në panel :

Gezim Qendro (ish-Drejtor i Galerise Kombetare/historian arti),

Parid Teferici, (artist /kurator), Elvis Hoxha (filozof/pedagog tek Shkolla e filmit Marubi)

Alban Hajdinaj (artist), Klod Dedja (artist).

Pjesa e dytë

- Prodhimi dhe promovimi i artit bashkohor si faktor zhvillimi territorial;
- Sponsorizimet: financimet alternative
- Problemet a audiences ne artin bashkohor: rrugedaljet .

Pjesëmarës në panel:

Andrea Bonifacio (administrator i Marco Polo system, Venecia),

Ilda Mara (presidente e ARGJIRO dhe koordinatorë e International Music and Art Foundation - I.M.A.F),

Fatjon Dragoshi (specialist për politikën kulturore).

Moderator: Andi Tepelena (president Art Kontakt)

Kjo konferencë u zhvillua ne kuadrin e mbylljes të ekspozitës të përvitshme “Onufri” dhe shërbeu për të bërë një reflektim, një analizë dhe vetë-kritikë për gjendjen e artit bashkëkohor në Shqipëri, në mënyrë që të thellohet debati në lidhje me këtë çështje.

Gjithashtu kjo konference synoi ngritjen e debatit në nivel kombëtar rreth raportit art/ekonomi. Këtij qëllimi i shërben njohja e rolit të arteve në shoqërinë civile si dhe gjetja e barazpeshave politike në këto fusha, ndikimi i ngjarjeve artistike në jetën ekonomike të një qyteti.

Konferenca u nda ne 2 pjese:

- ❖ e para pati nje profil teorik ne aspektin e evidentimit te problemeve qe karakterizojne prodhimin dhe promovimin e artit te sotem;
- ❖ Ndersa pjesa e dyte pati nje profil ekonomik dhe aspektet e financimit

Argumentet që u trajtuan:

1 - Ekspozita Onufri: Historia dhe momentet kyçe: Roli i kuratorit

Onufri duhet te jete nje deshmi e tendencave te artit ne Shqiperi dhe te jete prodhues qe gjalleron debatin e artit bashkohor. Onufri te mos jete deshmi pasiv por te kuptoje shijet e kohes qe jetojme, forma dhe stile mendime te kohes, zhvillimet sociale te kohes.

a) Rregulla te percaktuara ne menyre te qarte dhe transparente per perzgjedhjen e kuratorit, te Onufrit, nisur nga cv, aftesia per te pasqyruar zhvillimet e vendit dhe nderkombetare, njohjet nderkombetare të kuratorit

b) Rregulla te qarta dhe transparente ne percaktimin e jurise te Onufrit.

c) Mbeshtetja financiare e koston te puneve te artisteve pjesemarres, realizimi i detyrueshem i katalogut, dhe prezantimi i tij perpara ose ditën e inagurimit.

Percaktimi i qarte perzgjedhjes te artisteve nisur nga cilesia e vepres te puneve te artistit, lidhja me tematiken e ekspozites, novacionit te artistik ne aspektin e medimeve, apo ekspozimi i puneve qe pasqyrojne zhvillimet estetike shoqerore domethenese te vendit dhe ato nderkombetare.

d) Dhenia e bursave per kuratore te rinj te artit ne institucione perendimore te artit qe do tu jepte mundesi atyre të krijojnë përvojë profesionale duke rritur cilesine artistike te eventeve te artit.

2. Qartesimi i statusit te artistit

Te qartesohet nje status i vecante per artistet. Ne tranzicionin shqiptar, kategoria e artisteve ka mbetur shume e papercaktuar ne thelbin legjisltiv. Artistet duhet te kene avantazhet e tyre si shoqerore, si fiskale, dhe nje çertifikim i tyre eshte mese i nevojshem sipas kriterëve te vendosura nga kriteret me specialistet e fushave perkatese.

3. Një mënyrë për të bërë sa më produktiv dialogun mes artit dhe politikës:

a) propozojmë krijimin një qendre të vazhdueshme për të krijuar një database e subjekteve që pavarësisht titujve, meren me artin bashkëkohor, që mbledhin kërkesat

opinionet dhe kërkesat e subjekteve të pranishëm në database.

b). Krijimin e dy organeve këshillave të pavarur të njohura nga Qeveria, e përbëre (edhe) nga anëtarët e forumit, kohëzgjatja e së cilës duhet të ketë një skadencë të ndryshme nga ato të qeverive. Njëri nga organet të kete si funksion mbështetjen ndaj administratave publike në krijimin e programeve shumëvjeçare për artet (te pakten 10 vjet) dhe tjetri të jete për garancinë e aplikimit të programeve dhe për transparencën e procedurave.

c) Vendosija e një bonusi, një shumë të ardhurash që i jepet njëherë në karrierën e një artisti për promovimin e tij – për të garantuar një numri sa më të madh të mundshëm mundësinë e promovimit të veprës së vet.

d) Shtimi i mundësive të pranisë jashtë të artistëve dhe veprave shqiptare, ashtu sikurse praninë e artistëve dhe veprave të huaja në territorin shqiptar.

e) financimi i një reviste të specializuar arti që do të ishte e domosdoshme për orientimin e shijeve estike të publikut dhe vlerësimin e duhur të ofertave artistike nga artistë dhe organizate artistike. Kjo reviste mundeson informacionin dhe pasqyrimin e zhvillimeve të artit në Shqipëri dhe Europë si dhe do të krijonte kushtet për krijimin e kritikës të specializuar të fushës së artit.

d) Gjithashtu krijimi i hapësirave të programeve dhe debateve televizive të artit bashkohor në televizionet kombëtare.

4. Rishikim i legjislacionit për fondacionet e artit në Shqipëri

Përgatitja e legjislacionit për krijimin e Fondacionit të arteve, (arte vizual, dans modern, teater eksperimental, muzikë) me natyrë gjysem publike dhe gjysem private e cila do të mundësonte thithjen e fondeve publike, private dhe të huaja. Krijimi i këtij fondacioni do të përmirësonte menaxhimin e burimeve njerëzore dhe financiare publike dhe private. Krijimi i Fondacioneve për artet me fonde publike dhe menaxhim privat të cilat garantojnë një fluks financimi publik të bazuar mbi ligje kombëtare dhe lokale bazuar në kontribute financiare vjetore. Detyra e fondacionit do të ishte kryesisht financimi i ngjarjeve artistike të cilat janë të rëndësishme për brandy-n e qyteteve, si dhe mbështetjen e shoqatave dhe artisteve kryesisht të rinj që nuk gjejnë hapësirë në tregun komercial të artit.

5. Ekonomia e artit: Sponsorizimi / Filantropia

Shteti dhe MTKRS duhet të luajë me shumë rolin e një rregullatori të promovimit të artit për të shtuar investimet private në art, kulturë dhe komunikim.

a) –Sponsorizimet: MTKRS dhe Ministria e Financave duhet të krijonë një klimë të volitshme për sponsorizimet, duke inkurajuar kompanitë publike apo private në Shqipëri që të financojnë aktivitetet, projektet, artistet, dhe të kenë si kundërshtim ulje të taksave.

b) Shteti nuk duhet të shihet si i vetmi burim financimi por duhet diversifikuar burimet financiare dhe menaxheret dhe producentet të orientohen në fondacione të ndryshme kombëtare dhe nderkombëtare, si dhe në perfaqësi të huaja të cilat mbështetnin artin. Organizatat artistike jo vetëm duhet të perfeksionojnë metodikat e tyre të afërimit të donatoreve lokal/kombëtar/nderkombëtar dhe 'joshjes' së kompanive të biznesit (sponsoreve) - gje e cila kërkon profesioniste të mirë jo-artistë, por ato duhet të hedhin

syte nga te ardhurat e fituara te cilat ne organizatat artistike serioze ne vende te shumta arrijne ne 40-45%. Nje diversifikim i tille i burimeve financiare do te siguronte pa asnje dyshim nje jete te gjate per organizatat pamvaresisht krizave ekonomike apo vendimeve politike (ose jo) te institucioneve publike apo perfaqesive diplomatike te akredituata ne vendin tone.